

**LEONARD DAUTI
MUSTAFA KARAPINJALLI**

PËRCAKTIMI I FOLJEVE TË PARREGULLTA NË GJUHËN SHQIPE¹

Parashtrim

Klasifikimi i foljes në gjuhën shqipe ka tërhequr vëmendjen dhe ka qenë objekt studimi për një numër të madh autorësh, shqiptarë dhe të huaj. Në studimet për gjuhën shqipe ndeshim pothuajse po aq klasifikime sa dhe autorë që janë marrë me të, sa që vështirë se mund të gjejmë dy klasifikime që të përputhen me njëri-tjetrin. Mospranimi i një modeli të vetëm klasifikimi mendojmë se ka ndodhur për dy arsye: (i) kompleksiteti që paraqet paradigma eptimore e foljes në gjuhën shqipe; (ii) baza teorike e metodologjike nga janë nisur autorët për hartimin e klasifikimeve përkatëse, e cila nuk mund të pretendohet të jetë e njëjtë dhe e njëtrajtshme përgjatë fazave të ndryshme të zhvillimit të mendimit gjuhësor shqiptar. Këto dy arsye kanë përcaktuar pikërisht edhe përzgjedhjen e kriterëve të ndryshme si bazë për klasifikimin e foljes në zgjedhime, ndër të cilët mund të përmendim: 1) fonema fundore e temës; 2) kundërvënia temë e së tashmes – temë e aoristit të mënyrës dëftore, e bazuar në dy kriterë ndihmëse: a) ndryshimet fonemore të temës; b) zgjerimi i temës foljore; 3) mbaresat vetore; 4) kriteri sasior (shih: Da Lece, 1716; Dozone, 1878; Kristoforidhi, 1882; Frashëri, 1886; Meyer, 1888; Hahn, 1854; Pekmezi, 1908; Weigand, 1913; Sheperi, 1927; Cipo, 1949; Demiraj, 1969; *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe*, 1976 (më poshtë: Dhrimo et al., 1976); Resuli, 1985; Buchholz & Fiedler, 1987; Çeliku, Karapinjalli & Stringa, 1998 (më poshtë: Çeliku et al., 1998); *Gramatika e gjuhës shqipe 1, morfologjia*, (1995) 2002 (më poshtë: Agalliu et al., 2002); Memushaj, 2012; Teichmann, 2019). Ndërsa për ndarjen në folje të rregullta dhe të parregullta, një ndarje përtej klasifikimit në zgjedhime, si kriter është

¹ Një falënderim i veçantë shkon për prof. as. dr. Albert Riskën, mendimet, idetë dhe vryjtimet e të cilit, të shprehura në bisedat e shpeshta që kemi zhvilluar veçanërisht për këtë çështje, por edhe për probleme të tjera gjuhësore, na kanë ndihmuar të qartësojmë interpretimin tonë për probleme thelbësore, si ai i rregullsive dhe parregullsive që krijojnë profilin e sistemit foljor të gjuhës shqipe.

Gjithashtu, shprehim falënderimin dhe mirënjohjen tonë për recensuesen prof. dr. Ludmila Buxheli, vërejtjet dhe sugjerimet e së cilës kanë qenë një ndihmesë dhe orientim i çmuar për përmirësimin e formës përfundimtare të artikullit.

marrë për bazë shmangia nga zgjedhimi i foljeve të rregullta. Për këtë ndarje në gramatikat më të fundit si kriter formal është marrë ndryshimi i plotë ose i pjesshëm i temës foljore (Dhrimo et al., 1976:243; Agalliu et al., 2002:284; Çeliku et al., 1998:136; Teichmann, 2019:38).

Në punimin tonë jemi përqendruar te gjetja e një kriteri sa më të argumentuar shkencërisht, mbi bazën e të cilit të mund të përcaktojmë një ndarje të qëndrueshme në folje të rregullta dhe të parregullta, si dhe të japim një klasifikim të foljeve të parregullta. Për këtë, fillimisht kemi bërë një parashtrim teorik mbi përcaktimin e një kriteri sa më objektiv, i cili t'i përgjigjet gjendjes së sotme të sistemit foljor të gjuhës shqipe, për ndarjen në folje të rregullta dhe të parregullta. Sipas nesh, mbështetja te një kriter formal, siç është marrja parasysh e mbaresave të kohës së tashme, ose e temës së foljes në të tashmen, nuk mund të japë një pasqyrë të saktë të modeleve të eptimit të foljes në gjuhën shqipe, sepse si temë bazë e foljes në këtë gjuhë herë del ajo e së tashmes e herë ajo e së kryerës së thjeshtë apo e pjesores. Parashtrimi ynë teorik ka synuar të përcaktojë rregullsitë dhe parregullsitë që veprojnë në zgjedhimin e foljeve dhe mbi bazën e tyre të përcaktohet sistematiciteti në temën foljore dhe mbaresat vetore për kohën e tashme, të kryerën e thjeshtë dhe pjesoren. Sipas kriterit të sistematicitetit të paradigmes eptimore gjatë zgjedhimit të foljeve kemi bërë ndarjen përkatëse në folje të rregullta dhe folje të parregullta. Për përcaktimin e foljeve të parregullta kemi shfrytëzuar *Fjalor i gjuhës shqipe* (2006), nga i cili kemi nxjerrë listën e plotë të foljeve, si dhe korpusin e gjuhës shqipe (http://web-corpora.net/AlbanianCorpus/search/?interface_language=en), të cilin e kemi shfrytëzuar për të gjetur dhe krahasuar format foljore që po përdoren në ligjërimin e shkruar me ato që parasheh norma standarde. Kjo për të nxjerrë në pah prirjet që veprojnë në shqipen e sotme.

Punimi është organizuar në dy pjesë. Në pjesën e parë argumentohet domosdoshmëria e një ndarjeje të re, duke nxjerrë në pah mangësitë e qëndrimeve të mëparshme në lidhje me këtë çështje. Jemi ndalur vetëm në gramatikat më të fundit, përkatësisht *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe*, *Morfologjia* (1976), *Gramatika e gjuhës shqipe I* (2002), *Gramatika praktike e gjuhës shqipe* (1998) dhe *Albanisch – Fremdsprachengrammatik* (2019), në të cilat klasifikimi i foljeve në zgjedhime dhe ndarja e foljeve në të rregullta dhe të parregullta është mëtuar të bëhet mbi baza sa më shkencore, duke u përqendruar në rrafshin sinkronik të gjuhës.

Në pjesën e dytë të punimit parashtrohet qëndrimi ynë teorik për gjetjen e një baze të përbashkët metodologjike për ndarjen e foljeve në të rregullta dhe të parregullta, duke u mbështetur në konceptin e rregullsisë dhe të parregullsisë morfologjike në sistemin foljor të gjuhës shqipe. Duke qenë se eptimi i foljes në gjuhën shqipe realizohet me anë të mbaresave vetore, por edhe me anë të kundërvënieve tematike (tema të ndryshme për veta, numër, kohë dhe mënyra të ndryshme), jemi përpjekur të gjejmë një kriter të përbashkët klasifikues, i cili të

mos anashkalojë asnjë nga këta dy parametra. Për këtë qëllim kemi argumentuar teorikisht se çfarë përbën rregullsi në paradigmen foljore në gjendjen e sotme të gjuhës. Një ligjësi morfologjike e kemi pranuar si rregullsi, kur ajo vepron mbi gjithë pjesëtarët e një bashkësie foljore. Kur nuk përmbushet ky kusht, çdo ligjësi është parë si parregullsi.

Mbi bazën e këtij përcaktimi kemi bërë ndarjen në folje të rregullta dhe të parregullta. Për foljet e parregullta kemi dhënë një listë të plotë, duke i klasifikuar sipas parregullsive që shfaqen i) në temën foljore, ii) në sistemin e mbaresave dhe iii) në natyrën arbitrare.

1. Ndarja në folje të rregullta dhe të parregullta

Sipas vlerësimit tonë, në klasifikimet më të fundit të foljeve të gjuhës shqipe foljeve të parregullta iu është rezervuar një numër shumë i kufizuar: 14 (Dhrimo et al., 1976:243; Agalliu et al., 2002:284; Çeliku et al., 1998:136), 11 (Teichmann, 2019:38). Kjo mund të shihet si pasojë e prirjes për të nxjerrë në pah “sistematicitetin” brenda sistemit foljor të shqipes, nga njëra anë, dhe e mungesës së argumentimit teorik të dallimit midis foljeve të rregullta dhe atyre të parregullta, nga ana tjetër. Mungesa e një konceptimi të mirëpranuar teorik për ndarjen në folje të rregullta dhe të parregullta dëshmohej më së miri në subjektivizmin që është i pranishëm në përzgjedhjen e kriterëve për përcaktimin e foljeve të parregullta. Në *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe* (1976) dhe në *Gramatika e gjuhës shqipe I* (1995, 2002), ndërsa përcaktohen pesë kriterë për klasifikimin e foljeve të rregullta në zgjedhime, nuk jepet një kriter i veçantë për përcaktimin e foljeve të parregullta, por te kriteri 2 theksohet: “Një folje, që gjatë zgjedhimit paraqit parregullsi që nuk e lejojnë të grupohet me folje të tjera, do të lihet jashtë klasifikimit në zgjedhime dhe do të trajtohet si e parregullt. Këtu është fjala jo vetëm për foljet supletive, por edhe për ato folje temat e të cilave gjatë zgjedhimit pësojnë ndërrime tingujsh, që në shqipen e sotme paraqiten të veçuara ...” (Demiraj, 1969:194; Dhrimo et al., 1976:238; Agalliu et al., 2002:278). Mbështetur në këtë kriter foljet e parregullta të gjuhës shqipe klasifikohen në dy grupe: i) folje supletive: *kam, jam, bie (rashë), bie (prura), ha, vij, rri, shoh, jap*; ii) folje josupletive: *them, dua, lë, vdes, vete* (Dhrimo et al., 1976:243; Agalliu et al., 2002:284).

Në *Gramatika praktike e gjuhës shqipe* (1998) jepet një kriter i vetëm për përcaktimin e foljeve të parregullta: ndryshimet në temën foljore (Çeliku et al., 1998: po aty). Ndonëse numri i foljeve të parregullta është po ai (14), nuk përfshihen si folje të parregullta *lë* dhe *vete*, por foljet *shpie, shtie*. Sipas autorëve të kësaj gramatike në folje të parregullta përfshihen: i) ato që dalin me të paktën një temë krejt të ndryshme: *jam, kam, bie (rashë), bie (prura), ha, jap, rri, vij, shoh*; ii) folje që dalin me ndryshime të pjesshme në tri temat bazë (e tashme, e kryer e thjeshtë, pjesore): *them, dua, vdes, shtie, shpie*.

Në *Albanisch – Fremdsprachengrammatik* (2019) merret për bazë një kriter i vetëm për përcaktimin e foljeve të parregullta: prania e një teme të ndryshme prej asaj të së tashmes në aorist dhe në pjesore (Teichmann, 2019:37). Si folje të parregullta renditen: *dua, jam, jap, kam, vij, bie (rashë), ha, rri, shoh, bie (prura), vdes*.

Për qëndrimin e mbajtur prej Çelikut et al. dhe Teichmann-it mund të bëhet kjo vërejtje metodologjike: ndërsa për ndarjen e foljeve në zgjedhime prej këtyre autorëve merret si kriter bazë eptimi, mbaresat vetore të foljeve, për përcaktimin/klasifikimin e foljeve të parregullta ky kriter injorohet, duke thyer në këtë mënyrë koherencën shkencore për arritjen e një klasifikimi të besueshëm. Nisur nga kjo vërejtje, mund të themi se tek autorë si Da Lece, Kristoforidhi, Frashëri e ndonjë tjetër, të cilët nuk kanë qenë nën trysninë për ta paraqitur shqipen një gjuhë sa më sistematike në kushtet e mungesës së variantit standard, përcaktimi i foljeve të parregullta ka qenë më koherent.

Çështja e parë që duhet shtruar për ndarjen në folje të rregullta dhe të parregullta është përcaktimi i kriterëve të argumentuara teorikisht, të cilat t'i përgjigjen gjendjes sinkronike të sistemit foljor të gjuhës shqipe.

2. Ligjësi që shfaqen si rregullsi dhe parregullsi në sistemin foljor të shqipes

Mendojmë se për të bërë ndarjen në folje të rregullta dhe të parregullta do të duhet të nisemi nga koncepti i 'rregullsisë' dhe 'i parregullsisë', duke synuar t'i përkufizojmë nisur nga një bazë e përbashkët teorike. Për rregullsi dhe parregullsi është folur pothuajse në të gjitha klasifikimet e foljeve të gjuhës shqipe, por në asnjë rast nuk është dhënë një kriter i argumentuar teorikisht për të përcaktuar se çfarë përbën rregullsi, përkatësisht parregullsi. Është marrë e mirëqenë që foljet që përfshihen në një zgjedhim apo klasë të caktuar, të përcaktuar sipas kriterëve klasifikuese, janë folje të rregullta, ndërsa ato që nuk mund të përfshihen në një grupim të tillë janë parë si folje të parregullta. Rregullsia dhe parregullsia janë kushtëzuar nga përzgjedhja e kriterëve klasifikuese, duke i lënë hapësirë të lirë subjektivizmit në përcaktimin e grupit të foljeve të rregullta dhe të parregullta.

Për të sqaruar rregullsitë dhe parregullsitë është e nevojshme të saktësojmë fillimisht se çfarë kuptojmë me ligjësi morfologjike që veprojnë në paradigmen foljore. Zgjedhimi i foljeve bëhet sipas modeleve të caktuara, të ngjizura në mendjen/kujtesën e folësve të një gjuhe natyrore. Një model i tillë mund të analizohet mbi bazën e rregullave të caktuara, mbi bazën e të cilave përftohet tërësia e formave foljore që kundërvihen me njëra-tjetrën në vetë, numër, kohë, mënyrë, diatezë. Kur një rregull i caktuar shtrihet brenda një

bashkësie² të caktuar foljore, atëherë kemi të bëjmë me një ligjësi. P.sh., dalja e foljes në të kryerën e thjeshtë me temë eptimi³ të ndryshme nga ajo e së tashmes, të bazuar në ndërrimin **je**→**o**, përbën një ligjësi, pasi ky rregull vepron te të gjitha foljet që në të tashmen dalin me temë me *-je-*: *sjell – solla, mbjell – mbolla, vjel – vola, ndjell – ndolla* etj. Kundërvënia që krijon e tashmja e foljes *vete* me të kryerën e thjeshtë (*vete - vajta*) nuk përbën ligjësi, pasi kjo kundërvënie nuk dëshmohet në asnjë folje tjetër, duke mbetur kështu dukuri e izoluar.

Veprimi i një ligjësie të caktuar bën që një bashkësi e caktuar foljore të karakterizohet nga një tipar/karakteristikë e caktuar morfologjike që e dallon atë nga një bashkësi tjetër.

Përcaktimi i rregullsive dhe parregullsive, sipas ligjësie që përcaktojnë tërësinë e paradigmes zgjedhimore, merr një rëndësi parësore për të bërë të mundur përcaktimin e kriteve sa më objektive mbi të cilat do të mund të bazohet klasifikimi sinkronik i foljeve të gjuhës shqipe.

Trajtimi i rregullsive dhe i parregullsive në përfitim të paradigmes flektive të foljes në gjuhën shqipe është bërë së pari nga Riza [(1966), 1997], por interpretimi prej tij i rregullsisë/parregullsisë lidhet ngushtësisht me temën foljore. Sipas konceptit të tij, rregullsia lidhet me ruajtjen e së njëjtës temë në të gjitha format foljore. Si forma përfaqësuese ai merr të tashmen, të kryerën e thjeshtë dëftore, si dhe pjesoren e paskajoren (Riza, 1997:170). Ky qëndrim, pra përcaktimi i rregullsisë dhe i parregullsisë mbi bazën e ndryshimeve të temës foljore, ndeshet edhe te autorë dhe gramatika të mëvonshme (Agalliu, 1969:203; Dhrimo et al., 1976; Çeliku et al., 1998; Agalliu et al., 1995, 2002; Teichmann, 2019). Në rregullsinë dhe parregullsinë e shtrijmë përtej këtij konceptimi të ngushtë dhe e lidhim jo thjesht me ruajtjen e temës foljore, por me ligjësitë që veprojnë si për përfitim të temës foljore, ashtu edhe me ato që përcaktojnë sistemin e mbaresave vetore.

Nëse shqyrtojmë cilindo klasifikim të deritanishëm, ne mund të analizojmë kriteret që janë ndjekur për përcaktimin e foljeve në një zgjedhim, klasë, apo nënklasë të caktuar, por e kemi të pamundur të zbulojmë për të gjitha rastet pse ky apo ai kriter bëhet shprehës i një rregullsie të caktuar. Në *Fonetika dhe gramatika ...* (1976) dhe *Gramatikë e gjuhës shqipe I* (2002) si të rregullta

² Përdorim konceptin ‘bashkësi’ për të shënuar një grup foljesh që karakterizohen nga tipare formale të përbashkëta, si natyra e temës, fonema fundore, zanorja ose grupi zanor i temës, sistemi i mbaresave që ato marrin gjatë zgjedhimit.

³ Kundërvëniet tematike do t’i analizojmë si kundërvënie temash eptimi dhe jo mbi bazën e ndërrimit të tingujve. Në këtë mënyrë ruajmë koherencën e analizës morfologjike, pa e ngatërruar atë me analizën fonetike. Për konceptin e temës së eptimit ose temës morfologjike, që këtu e marrim të mirëqenë, shih: Dhrimo et al., 1976:28; Agalliu, 1981:41; Agalliu et al., 2002:52.

paraqiten edhe foljet me temë më *-ua* që e zgjerojnë temën më *-jt* në të kryerën e thjeshtë (*gjuaj – gjuajta, ruaj - ruajta*), edhe ato që e bashkojnë grupin *-ua* në *-o* në këtë kohë (*shkruaj – shkrova, paguaj - pagova*). Është e paqartë pse brenda të njëjtës bashkësi foljesh prania e dy temave të ndryshme të eptimit në të kryerën e thjeshtë nuk kërkon interpretimin e tyre sipas rregullsisë dhe parregullsisë. Këtu do të ishte i domosdoshëm një argumentim teorik i përfshirjes së dy modeleve të ndryshme të eptimit të temës foljore në ‘rregullsi’. Nga ana tjetër, nisur nga kriteri i përcaktuar prej autorëve për foljet e parregullta në të dyja veprat e mësipërme, lihet të kuptohet se parregullsia gjendet vetëm tek modelet e veçuara, pra tek foljet që dalin me ndërrime tingujsh të veçuara. Po folje që nuk dalin të izoluara, si *vë, zë, nxë*, a mund të jenë të parregullta?

Në sistemin foljor të gjuhës shqipe përfitimi i paradigmës flektive të foljes është rezultat i veprimit të ligjësive të natyrës historike dhe sinkronike. Këto ligjësi përcaktojnë si sistemin e mbaresave ashtu edhe ndryshimet që pëson tema foljore. Nën këndvështrimin diakronik ndryshimet që shfaqen në sistemin e mbaresave vetore dhe ato të temës foljore janë të gjitha të rregullta, pasi iu përgjigjen ligjësive që kanë vepruar në kohë të ndryshme, ndërsa nën këndvështrimin sinkronik një pjesë e ndryshimeve janë të rregullta, kurse pjesa tjetër e tyre shfaqen si ndryshime të parregullta. Kjo lidhet me faktin që ligjet “kanë fuqi për një periudhë të caktuar historike e për një truall gjuhësor të caktuar.” (Çabej, 1988:12). Çështja është se *mbi ç’kriter do të mund të përcaktojmë nëse një ligjësi e caktuar mund të klasifikohet si rregullsi apo parregullsi?* Ne mendojmë se kriteri më i saktë për këtë ndarje është karakteri gjithëpërfshirës i ligjësisë për një bashkësi të caktuar foljore. Pra, kur një tipar morfologjik është i përbashkët për të gjithë anëtarët e një bashkësie të caktuar foljore, atëherë kemi të bëjmë me rregullsi. Kur ligjësia vepron vetëm mbi një pjesë të bashkësisë, pra mbi një numër të kufizuar foljesh, atëherë ajo përbën parregullsi.

Prania e një ligjësie të caktuar në formën e rregullsisë për një bashkësi foljore mbështetet nga raporte sistematike paradigmatiche mes formave foljore përkatëse. Një ligjësi e tillë është e gjallë në rrafshin sinkronik, d.m.th. vepron edhe mbi njësitë e reja leksikore që mund të bëhen pjesë e kësaj bashkësie. Sipas këtij përkufizimi rregullsi mund të kemi jo vetëm kur ruhet e njëjta temë, por edhe kur kemi një ndryshim të caktuar të temës, ndryshim i cili është gjithëpërfshirës dhe të cilit i nënshtrohen edhe prurjet e reja leksikore.

Për foljet në *-o* ne mund ta përshkruajmë kundërvënien e temave mbi bazën e ndërrimit/zbërthimit *o*→*ua* si dukuri që shfaqet në shumësin e të kryerës së thjeshtë dhe në pjesore. Në këtë rast identifikimi i kësaj dukurie ka jo vetëm vlerë përshkruuese por edhe parashikuese, pasi çdo folje e re më *-o* që futet rishtazi në sistemin foljor të gjuhës shqipe do t’i nënshtrohet një kundërvënieje të tillë. Pra, jo vetëm shqipfolësi që e ka të ngulitur në kujtesën e tij modelin e kundërvënies së temave, por edhe dikush që e mëson shqipen si

gjuhë të dytë mbi bazën e kësaj ligjësie mund ta zgjedhë shumë mirë çdo folje më **-o**. Në këtë mënyrë, aftësia parashikuese e një ligjësie të caktuar mund të shërbejë edhe si një kriter praktik për të vërtetuar saktësinë/korrektësinë e përcaktimit të saj si e rregullt ose e parregullt.

Nëse japim paradigmen flektive të foljes *dal* dhe ligjësitë përkatëse që përshkruajnë eptimin e temës së saj ($[\mathbf{T}_{(-a)-}^{a \rightarrow e}]_{\text{TVII/III.nj.t.d.}}$; $[\mathbf{T}_{(-e)-}^{e \rightarrow i}]_{\text{TVII.sh.t.d.}}$; $[\mathbf{T}_{(-a)-}^{a \rightarrow o}]_{\text{TKr.th.}}$ ⁴) është e pritshme që folje me tema të ngjashme me të, si *fal*, *kall*, etj., të zgjedhohen në të njëjtën mënyrë. Por nuk ndodh kështu, pasi këto folje nuk e ndryshojnë temën e tyre. Kjo e rrëzon statusin e këtyre ligjësive si të rregullta.

Një ligjësi e caktuar shfaqet si parregullsi, kur ajo nuk është gjithëpërfshirëse për një bashkësi të caktuar foljesh dhe nuk arrin të krijojë raporte paradigmatiche sistematike mes formave foljore përkatëse. Kjo mënyrë e përcaktimit të parregullsisë në paradigmen zgjedhimore të foljeve lejon të interpretohen si të parregullta edhe ligjësi që janë të gjalla në rrafshin sinkronik, por që nuk janë gjithëpërfshirëse. Le të shohim rastin e foljeve që në të kryerën e thjeshtë dalin me **temë-T: arrij, gjej, luaj**. Ne e përshkruajmë dukurinë e zgjerimit të temës me **-t**, por kjo dukuri nuk ka vlerë parashikuese, pasi do të ishte e pritshme që këto folje të zgjedheshin në të kryerën e thjeshtë sipas modelit të foljeve në zanore: *arriva, arrive, arriu* etj., sikurse *fshiva, gdhiva, shkriva, ngriva, shtriva* dhe jo: *arrita, arrite, arriti*. Në këtë mënyrë, kjo ligjësi nuk mund të klasifikohet si rregullsi e zgjedhimit të foljes, por si shmangie nga rregullsia, pra si parregullsi. Dalja në të kryerën e thjeshtë me temë më **-t** e foljeve që në të tashmen dalin me temë më zanore është një dukuri e gjallë e sistemit foljor. Mjaft folje me temë më grup zanor, si *shkruaj, kruaj, rruaj* etj., sot po përdoren në të kryerën e thjeshtë edhe me **temë-T**, krahas temës më **-o**: *shkrova/shkruajta, krova/kruajta, rrova/rruajta*. Kjo dëshmon se dukuria e zgjerimit të temës në të kryerën e thjeshtë është një ligjësi sinkronike. Por, pavarësisht kësaj, ajo nuk është gjithëpërfshirëse, pasi nuk është shtrirë te të gjitha foljet: *arrij - arrita*, por edhe *mërdhij - mërdhiva* etj.

Nga ana tjetër, një pjesë e ligjësive që kanë vepruar në një kohë të caktuar dhe sot nuk veprojnë më, ndonëse dikur mund të përbënin një rregullsi, sot mund të shfaqen si parregullsi. P.sh.: ndërrimi **ie** → **o** në të kryerën e thjeshtë, *vjel - vola, tjerr - tora, nxjerr - nxora* etj., i cili mund të shihet si një rregullsi, pasi vepron te të gjitha foljet me grupin **ie/je** të pranishëm në temën e tyre, për shkak të zhvillimeve fonetike të karakterit historik dëshmohet edhe si ndërrim

⁴ Me anë të këtyre formulave kemi paraqitur gjedhen e përfutimit të temës së eptimit mbi bazën e ndërrimeve që pësojnë zanoret tematike. Në $[\mathbf{T}_{(-a)-}^{a \rightarrow e}]_{\text{TVII/III.nj.t.d.}}$ **T**_{(-a)-} shënon temën foljore bazë me zanore të theksuar **-a-**; **a** → **e** shënon ndërrimin përkatës që ndodh në zanoren e theksuar të temës bazë. Mbi bazën e këtij ndërrimi është përfutur tema e vetës së dytë dhe të tretë njëjës të së tashmes dëftore (TVII/III.nj.t.d.). Sipas kësaj mënyre lexohen edhe formulat e tjera.

e→o: *heq – hoqa, dredh – drodha, mbledh – mblodha*, por në këtë rast shfaqet si parregullsi, pasi foljet e tjera më **-e** nuk e ndërrojnë atë në të kryerën e thjeshtë: *fsheh - fsheha* (por jo **fshoha*), *leh - lehu* (**lohu*), *ndreq - ndreqa, prek – preka* etj.

Në përputhje me rregullsitë dhe parregullsitë që karakterizojnë paradigmen e zgjedhimit të foljeve në gjuhën shqipe do të bëhet ndarja e tyre në dy klasat përkatëse: i) folje të rregullta, ii) folje të parregullta dhe do të respektohen parimet e mëposhtme:

1. rregullsitë dhe parregullsitë do të shihen jo vetëm te temat, por edhe te mbaresat foljore⁵;
2. analiza do të jetë e rrafshit sinkronik dhe jo atij diakronik;
3. tema bazë për të përcaktuar rregullsitë dhe parregullsitë tematike do të merren e tashmja, e kryera e thjeshtë dhe pjesorja;
4. kriteri numerik, përkatësisht dalja me paradigmë të izoluar, nuk do të jetë përcaktues për përcaktimin e foljeve të parregullta.

Nëse nisemi nga anglishtja, do të shohim se si folje të parregullta nuk dalin vetëm ato që janë të izoluar:

E tashme	E shkuar	pjesore
<i>bring</i>	<i>brought</i>	<i>brought</i>
<i>buy</i>	<i>bought</i>	<i>bought</i>
<i>think</i>	<i>thought</i>	<i>thought</i>
<i>teach</i>	<i>taught</i>	<i>taught</i>
<i>cut</i>	<i>cut</i>	<i>cut</i>
<i>hit</i>	<i>hit</i>	<i>hit</i>
<i>hurt</i>	<i>hurt</i>	<i>hurt</i>
<i>let</i>	<i>let</i>	<i>let</i>
<i>put</i>	<i>put</i>	<i>put</i>
<i>set</i>	<i>set</i>	<i>set</i>

Po e njëjta dukuri vërehet edhe për gjermanishten:

⁵ Ndonjë folje, si *përbëj* del me paradigmë të paplotë. Nuk kemi përdorim të kësaj foljeje për vetën I dhe II të së kryerës së thjeshtë. Kushtëzimi në këtë rast është i natyrës semantike dhe prek sferën e ligjërit. Format *përbëra, përbëre*, ndonëse nuk ndeshen në përdorim, mund të konsiderohen si forma potenciale, sipas modelit të zgjedhimit të foljes *bëj*.

paskajore	v III e tashme	v III e pakryer	pjesore
<i>essen</i>	<i>isst</i>	<i>aß</i>	<i>gegessen</i>
<i>fressen</i>	<i>frist</i>	<i>fraß</i>	<i>gefressen</i>
<i>geben</i>	<i>gibt</i>	<i>gab</i>	<i>gegeben</i>
<i>sitzen</i>	<i>sitzt</i>	<i>saß</i>	<i>gesessen</i>
<i>treten</i>	<i>tritt</i>	<i>trat</i>	<i>getreten</i>
<i>beginnen</i>	<i>beginnt</i>	<i>begann</i>	<i>begonnen</i>
<i>gewinnen</i>	<i>gewinnt</i>	<i>gewann</i>	<i>gewonnen</i>
<i>schwimmen</i>	<i>schwimmt</i>	<i>schwamm</i>	<i>geschwommen</i>

Kriteri sasiar, përkatësisht ai numerik, nuk mund të jetë përcaktues për rregullsinë apo parregullsinë. Kjo do të thotë që jo vetëm ato folje që dalin me paradigme të izoluar mund të jenë të parregullta. Është e vërtetë që çdo folje e izoluar është e parregullt, por nuk është e vërtetë që çdo folje e parregullt është e izoluar.

Nisur nga parimet e mësipërme, si kriter bazë për ndarjen *folje e rregullt* – *folje e parregullt* do të përcaktojmë **sistematicitetin e paradigmës flektive për gjatë zgjedhimit të foljes**, i parë në dy tregues:

[a.] fleksionin e jashtëm –përkatësisht, përkitshmëria në sistemin e mbaresave përtë tashmen, të pakryerën, të ardhmen e të kryerën e thjeshtë të dëftores;

[b.] fleksionin e brendshëm – sistematiciteti që shfaq tema foljore në të tashmen, të pakryerën dhe të kryerën e thjeshtë.

Sistemi i mbaresave mund të mos jetë kriter përcaktues, pasi folje që dalin me temë të ndryshme në të tashmen dhe të kryerën e thjeshtë bashkohen për sa i përket fleksionit, ato karakterizohen nga fleksioni i rregullt (*dal, heq, djeg* etj.). Në këtë rast sistematiciteti që shfaq tema është kriter më specifik dhe si i tillë do të merret si bazë për ndarjen në folje të rregullta dhe të parregullta. Ato folje tema e të cilave i nënshtrohet një ligjësie sistematike në të tashmen, të pakryerën dhe të kryerën e thjeshtë përbëjnë grupin e foljeve të rregullta. Të gjitha foljet e tjera, të cilat duket të jenë të shumta në numër, formojnë grupin e foljeve të parregullta. Po kështu mund të ndodhë që folje me temë të rregullt të hyjnë në grupin e foljeve të parregullta për shkak të parregullsisë në sistemin e mbaresave (*pi, bëj, hyj*):

la-j – la-va – la-rë
pi-Ø – pi-va – pi-rë;
bë-j – bë-r-a – bë-rë
hy-j – hyr-a – hy-rë

Pra vetëm kur sistemi i mbaresave dhe tema foljore janë të organizuara mbi bazën e rregullsisë kemi folje të rregullta; në të gjitha rastet e tjera kemi folje të parregullta.

Mbi bazën e këtyre parimeve si rregullsi në sistemin foljor të gjuhës shqipe kemi përcaktuar:

- praninë në dëftore veprorë të dy temave të eptimit falë zberthimit **o→ua**; **e→ye** në shumësin e të kryerës së thjeshtë të foljeve me temë më zanore (*lexoj – lexuam, dëgjoj – dëgjuam, shkoj – shkuam; rrëfej – rrëfyem, ushqej – ushqyem* etj.);

- praninë në dëftore veprorë të dy temave të eptimit falë monoftongimit **ua→o**; **ye→e** në të kryerën e thjeshtë njëjës të foljeve me temë më grup zonor (*shkruaj – shkrova, thyej – theva* etj.);

- praninë në dëftore veprorë të dy temave të eptimit falë ndërrimit **je→o** në të kryerën e thjeshtë të foljeve me temë më bashkëtingëllore (*sjell – solla, vjel – vola* etj.);

- mungesën e mbaresës për tri vetat e njëjës të së tashmes dëftore për foljet me temë më bashkëtingëllore (*hap, kap, lidh, godit, ujit* etj.);

- mosndryshimi i temës në të gjitha kohët e mënyrës dëftore (*la-j, qa-j, ujit, godit, qëndis, kap* etj.).

Si parregullsi kemi përcaktuar ligjësitë e mëposhtme:

- mosprania e mbaresës për tri vetat e njëjës të së tashmes dëftore për foljet me temë më zanore (*ha, pi, rri, zë* etj.);

- prania e mbaresës për tri vetat e njëjës të së tashmes dëftore për foljet me temë më bashkëtingëllore (*ik-i, ik-ën, ik-ën; ec-i, ec-ën, ec-ën, hip-i, hip-ën, hip-ën*);

- ndryshimi i temës në vetën e dytë dhe të tretë njëjës të së tashmes dëftore (*rrëshqas, rrëshqet; bërtas, bërtet; buças, buçet* etj.);

- rishfaqja e **n-së (r-së)** tematike për foljet me temë më zanore (*bë-j – bë-r-a, zë – zur-a – zën-ë* etj.).

Mund të ndodhë që e njëjta ligjësi (tipar) të shfaqet si rregullsi për një bashkësi të caktuar foljesh dhe si parregullsi për një bashkësi tjetër. Kështu dalja me **temë—T** në të kryerën e thjeshtë për foljet me temë më grupin zonor **ua** (*luaj, vuaj, ruaj*) sot përbën rregullsi. Në ligjërimin e folur po mbizotëron përdorimi me **temë—T** edhe për foljet që sipas normës standarde duhet të dalin më **-va**: *shkruajt-a, paguajt-a, rruajt-a* etj. Por për foljet me temë më zanore, si *arrij, gjej* etj., kjo shfaqet si parregullsi, pasi për këtë tip foljesh kjo nuk është dukuri gjithëpërfshirëse.

2.1 Foljet e rregullta

Në bashkësinë e foljeve të rregullta do të përfshihen ato folje eptimi i të cilave është i përshkueshëm mbi bazën e ligjësive që përbëjnë rregullsi në

rrafshin sinkronik. Mbi bazën e rregullsive të mësipërme në folje të rregullta hyjnë:

1. Foljet me temë më zanore ose bashkëtingëllore që ruajnë të njëjtën temë në të gjitha vetat dhe kohët dhe të cilat respektojnë systematicitetin e paradigmës flektive: *laj, thaj, fshij, nxij; prek, lidh, godit, qëndis, sos, varros* etj.

2. Foljet me temë më zanoren **-o/-e**, të cilat e zbërthejnë atë respektivisht në **-ua/-ye** në të kryerën e thjeshtë shumë dhe në pjesore: *shikoj, mendoj, afro, lëvdoj; rrëfej, ushqej, dëfrej, kërcej* etj.

3. Foljet me temë më grupin zanor **-ua/-ye** që në të kryerën e thjeshtë dalin me **temë-T**: *drua-j – druajt-a, gjua-j – gjuajt-a, huaj, kruaj, luaj, quaj, ruaj, shquaj, truaj, vuaj*. Edhe foljet *bluaj, gatuj, paguaj, rruaj, shkruaj, shuaj*, për të cilat norma njih të kryerën e thjeshtë me temë më zanore, *blo-va, gato-va*, në ligjërimin gojor, por edhe në atë të shkruar⁶, dalin edhe me **temë-T**: *shkruajta, bluajta, shuajta, paguajta* etj.

2.2 Foljet e parregullta

Për foljet e parregullta pyetja që shtrohet sot është kjo: *A është e vërtetë që gjuha shqipe qenka një gjuhë kaq sistematike me një numër kaq të kufizuar foljesh të parregullta, vetëm 11 apo 14?* Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje duhet bërë saktë dallimi midis foljeve të rregullta dhe foljeve të parregullta, duke marrë për bazë kritere sa më të sakta që do t'i përgjigjeshin gjendjes së sotme të sistemit foljor të gjuhës shqipe.

Duke respektuar kriterin e mësipërm, systematicitetin e sistemit të mbaresave vetore dhe të temës foljore, në bashkësinë e foljeve të parregullta do të përfshihen:

1) folje ndryshimi i temës së të cilave shfaqet si parregullsi:

a. Foljet që në të tashmen e dëftores dalin me temë më zanore, ndërsa në të kryerën e thjeshtë dhe në pjesore dalin me **temë-T**⁷: *arri-j – arrit-a – arrit-*

⁶ Në korpusin e gjuhës shqipe:

http://web-corpora.net/AlbanianCorpus/search/?interface_language=en kemi gjetur raste përdorimi me temë-T për foljet *shkruaj, bluaj, shuaj*, ndërsa në ligjërimin e folur edhe për *paguaj*.

⁷ Nisur nga qëndrimi i mbajtur për variantin standard në *Gramatika e gjuhës shqipe*, 1, *Morfologjia* (1995, 2002) edhe foljet me temë më grupin zanor **-ua** do të duhej të klasifikoheshin si të parregullta, pasi një pjesë e tyre në të kryerën e thjeshtë dalin me temë më zanore: *shkro-va, rro-va, pago-va* etj. Por duhet të kemi parasysh se dukuria e zgjerimit të temës në të kryerën e thjeshtë për këto folje është bërë gjithëpërfshirëse, siç po vërehet jo vetëm në ligjërimin e folur, por edhe në atë të shkruar. Ndeshet rëndom *shkruaj shkrova/shkruajta, kruaj krova/kruajta, rruaj rrova/rruajta, paguaj pagova/paguajta* etj. Kjo është dëshmi e lëvizjeve që ndodhin në sistemin foljor të gjuhës shqipe dhe, nëse kjo prirje do të vazhdojë të shtrihet edhe për foljet me temë më

ur; bre-j – brejt-a – brejtur, gje-j – gjet-a – gjetur, gogësisj, huaj, bluaj, lërej, mbaj, mbërrij, mbroj, mbroj, mërij, shuj, ruaj, teshtij, ulërij, vetëmbrohet, vërej, vlej, fyej, zbruj, zdërvaj, buj, bëzaj.

Në të tashmen dhe të pakryerën këto folje dhe derivatet e tyre i bashkohen modelit të foljeve me temë më zanore, ndërsa në të kryerën e thjeshtë dhe në pjesore modelit të zgjedhimit të foljeve me temë më bashkëtingëllore.

b. Foljet që në të tashmen e dëftores dalin me temë më zanore, ndërsa në të kryerën e thjeshtë njëjës dhe pjesore dalin me **temë-R**: *bë-j – bër-a – bër-ë, hy-j – hyr-a – hyr-ë.*

Sikurse foljet e grupit (1) edhe këto folje ndërsa i bashkohen modelit të zgjedhimit të foljeve në zanore, në të kryerën e thjeshtë njëjës i bashkohen modelit të zgjedhimit të foljeve në bashkëtingëllore.

Dalja me **temë-R** për këto folje është rast përjashtimor dhe jo rregullsi, pasi foljet e tjera, si *shtyj, ndyj, ndaj, fshij, grij* etj., nuk e ndryshojnë temën, çfarë përbën një rregullsi të zgjedhimit të foljeve në zanore.

c. Foljet në bashkëtingëllore që në të kryerën e thjeshtë dhe pjesore dalin me temë të shkurtër: *flas⁸ – fol-a, humbas – humb-a⁹, këllas – kall-a, këlthas – klith-a, pëllas – pall-a, thërras – thirr-a.*

d. Folje me temë më bashkëtingëllore që dalin me tri forma të ndryshme të temës në veta dhe kohë të ndryshme falë ndërrimeve **e/ie→i, e/ie→o**: *dredh, bredh, hedh, heq, tredh, mbledh; pjerdh, vjedh; je→o, k→q: ndjek, pjek, djeg.* Foljet e përfshira këtu dhe që pësojnë ndërrimin **je→o** e formojnë pjesoren më **ur**, duke u veçuar në këtë mënyrë nga grupi i foljeve të rregullta, si *vjel, sjell*, që e formojnë pjesoren më **-ë**.

e. Foljet me temë në bashkëtingëllore që dalin me tri forma të temës si pasojë e ndërrimit të zanores dhe të bashkëtingëllores (**a→e→i; s→t**): *kërcas – kërcita, pres – prita, thërras – thërrita, shes – shita, rrëshqas – rrëshqita, zbres – zbrita, pëlcas – pëlcita, gërhas – gërhitita, godas – godita, shes – shita, buças – buçita, gërgas – gërgita.*

zanore, në një të ardhme zgjerimi i temës mbetet të konsiderohet si rregullsi e zgjedhimit të foljes.

⁸ Folja *flas* ka pësuar edhe ndryshime të tjera: *flas < fëlas < folas < fol+-as*. Te *përflas*, si krijim i mëvonshëm, nuk mund të pretendojmë se janë të ngjizura ndryshimet e mësipërme, pasi ajo zgjedhohet sipas modelit të foljes bazë *flas*, duke respektuar kundërvëniet tematike përkatëse. Ne i përmbahemi mendimit se zgjedhimi bëhet sipas modeleve të përfuara mbi bazën e kundërvënieve tematike dhe jo ndërrimeve të tingujve brenda temës foljore.

⁹ Për foljen *humbas* tema e të tashmes është një temë dytësore që përdoret krahas temës së rregullt *humb*. Po e njëjta vërejtje vlen edhe për foljen *këllas, këlthas*.

f. Foljet të cilat në të tashmen e dëftores dalin me temë në bashkëtingëllore, ndërsa në të kryerën e thjeshtë dhe pjesore me temë në zanore, falë ndërrimit **e→i**, **s→t**: *pres – pret – pris-ni – pre-va – prerë, dhjes, vras, shkas, ngas*. Këto folje e ndryshojnë modelin e zgjedhimit, duke kaluar nga modeli i zgjedhimit të foljeve në bashkëtingëllore për të tashmen, të pakryerën dhe të ardhmen në modelin e zgjedhimit të foljeve në zanore në të kryerën e thjeshtë dhe pjesore.

g. Foljet me temë në bashkëtingëllore që dalin me katër forma të ndryshme të temës si pasojë e ndërrimeve fonemore në veta dhe kohë të ndryshme falë ndërrimeve **a→e**, **e→i**, **a→o**: *dal- (del-, dil-, dol-), marr- (merr-, mirr-, mor-)*.

2) folje të cilat i shmangen sistematicitetit të mbaresave të foljeve të rregullta:

a. Foljet më zanore, *pi* etj., të cilat në të tashmen njëjës i bashkohen modelit të zgjedhimit të foljeve në bashkëtingëllore, ndërsa në të tashmen shumës, të kryerën e thjeshtë dhe pjesore modelit të zgjedhimit të foljeve në zanore: *pi-φ – pi-më – pi-va – pi-rë*.

b. Foljet në zanore të cilat në të tashmen njëjës i bashkohen modelit të zgjedhimit të foljeve në bashkëtingëllore, në shumës modelit të zgjedhimit në zanore, në të kryerën e thjeshtë njëjës modelit të zgjedhimit në bashkëtingëllore, pasi dalin me **temë-R**, ndërsa në të kryerën e thjeshtë shumës modelit të zgjedhimit të foljeve në zanore: *vë – vë-më – vur-a – vu-më, zë, nxë, shpie*.¹⁰ Tema bazë e formimit të pjesores së këtyre foljeve del më **-n**: *vën-ë, zën-ë*.

c. foljet në zanore që në të tashmen dalin me mbaresë zero, ndërsa në të kryerën e thjeshtë dalin me **temë-T**: *di, fle, ngre*. Foljet që dalin më zanoren **-e** pësojnë edhe ndërrimin **e→i**: *di – dit-a – ditur; fle – fli-ni – fjet-a – fjetur; ngre – ngri-ni – ngrit-a – ngritur*.

3) folje ndryshimet në temën dhe sistemin e mbaresave të së cilave shfaqen si ndryshime arbitrare:

a. Foljet që dalin me dy ose tri tema të ndryshme (foljet supletive): *jam (ish-, qe-), jap (dha-), kam (kish-, pat-a), shoh (pa-), rri (ndenj-), ha (hëngr-, ngrën-), sjell (prur-), vij (erdh-/ardh-, eja-), bie (soll-), bie (ra-)*. Në rrafshin diakronik ndonjë nga këto tema mund të jetë e motivueshme, p.sh., për foljen *vij* tema e të tashmes dhe e të pakryerës lidhet me *venio* të latinishtes (Topalli, 2018:1571), *erdh-/ardh-* e trashëguar (po aty, 450), por lidhja midis tyre është

¹⁰ Foljet e këtij nëngrupi, por edhe ato të nëngrupit (2c), shfaqin parregullsi jo vetëm në sistemin e mbaresave, por edhe në temën foljore. Mbaresat e të kryerës së thjeshtë njëjës, për grupin (2c) edhe shumës, janë të kushtëzuara nga dalja e temës më bashkëtingëllore. I kemi përfshirë në këtë grup, pasi mbaresa zero e së tashmes njëjës të dëftores është e karakterit arbitrar.

arbitrare në kuptimin që struktura fonologjike e morfologjike e njëres temë nuk kushtëzon dhe as kushtëzohet prej strukturës së tjetrës.

b. foljet që e formojnë të kryerën e thjeshtë vI.nj. sipas modelit të vjetër të aoristit sigmatik¹¹: *lë- lash-*, *them- thash-*, *dua - desh-a*.

c. folje ndryshimet në temën e të cilave nga këndvështrimi sinkronik mund të interpretohen si arbitrare: *vdes - vdis-ni - vdiq-a - vdek-ur*.

d. foljet që dalin me paradigme zgjedhimi të izoluar: *shtie, vete*.

Përfundime

Çfarë bie në sy nga trajtimet e deritanishme të grupit të foljeve të parregullta në gjuhën shqipe është fakti që në asnjë rast autorët që janë marrë me këtë çështje nuk janë pajtuar me qëndrimin e autorëve pararendës. Edhe atëherë kur numri i foljeve të rregullta përputhet, lista e foljeve të parregullta nuk është e njëjtë. Kjo dëshmon për mosndjekje të kriterëve të njëjta, jo për përcaktimin e foljeve të parregullta, por për klasifikimin e foljeve të rregullta. Nëse do të kishte një pajtim për klasifikimin e foljeve të rregullta, atëherë vetvetiu do të ishte pranuar edhe “kompromisi” për foljet e parregullta.

Një faktor që ka luajtur rol të madh në përcaktimin e kriterëve për grupimin e foljeve të parregullta është edhe metodologjia e ndjekur. Ndërsa për klasifikimin e foljeve të rregullta merren kriterë të përcaktuara qartë, për foljet e parregullta kriteret e përcaktuara, në mjaft raste, nuk janë të harmonizuara me të parat, pasi nuk janë hartuar mbi një bazë të përbashkët metodologjike.

Në punimin tonë kemi synuar të argumentojmë pikërisht përcaktimin e kriterëve sa më objektive, gjithmonë në rrafshin sinkronik, që të mundësojnë dallimin e qartë mes foljeve të rregullta dhe atyre të parregullta. Për ta bërë të mundur këtë kemi gjukuar si rrugën më të saktë përcaktimin e rregullsive dhe të parregullsive që përcaktojnë sot paradigmen e zgjedhimit të foljeve të gjuhës shqipe. E thënë ndryshe, nëse paradigma e zgjedhimit të foljes shihet si prodhim i një sërë ligjësive flektive (ndryshim i mbaresave ose temës foljore sipas rregullave të caktuara morfologjike), morfonologjike (ndryshime të shkaktuara në sistemin e mbaresave nën ndikimin e ndryshimeve që pëson tema foljore) dhe arbitrare, ne kemi synuar të përcaktojmë fillimisht ato ligjësi që në gjendjen e sotme të gjuhës janë të klasifikueshme si rregullsi, dhe ato ligjësi që janë të klasifikueshme si parregullsi. Si rregullsi kemi përcaktuar ato ligjësi që veprojnë sot në gjuhë dhe që janë gjithëpërfshirëse për një bashkësi të caktuar foljesh. Në një bashkësi foljesh përfshihen ato folje që ndjekin një model të caktuar zgjedhimi mbi bazën e një sistemi të përbashkët mbaresash dhe eptimi të temës sipas të njëjtës ligjësie. Parregullsitë nuk kanë karakter gjithëpërfshirës dhe në të shumtën e rasteve janë produkt i ligjësive historike.

¹¹ Në grupin e foljeve supletive bëjnë pjesë edhe disa folje që e formojnë vI.nj.kr.th.d. sipas modelit të aoristit sigmatik: *jam - qesh-ë, jap - dhash-ë, shoh - pash-ë, bie - rash-ë*.

Parregullsitë e kemi dalluar në sistemin e mbaresave – dalja e një mbarese të paparashikuar aty ku duhej të dilte një mbaresë tjetër – dhe në eptimin e temës foljore, rastet kur ndryshimet e temës janë jo gjithëpërfshirëse për një bashkësi të caktuar foljesh.

Të gjitha ato folje në paradigmen e të cilave është i pranishëm veprimi i një parregullsie i kemi përcaktuar folje të parregullta. Sipas klasifikimit tonë numri i foljeve të parregullta është rreth 85¹².

BIBLIOGRAFI

- Agalliu, F. (1969), *Diskutim rreth problemit të klasifikimit të foljeve në zgjedhime*. SF, 3/1969.
- Agalliu, F., Angoni, E., Demiraj, Sh., Dhrimo, Ali., Hysa, E., Lafe, E. & Likaj, E. (2002), *Gramatika e gjuhës shqipe 1, vëllimi I, morfologjia* (botimi i tretë). Botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë.
- Cipo, K. (1949), *Gramatika Shqipe*. Tiranë.
- Çabej, E. (1988), *Studime për fonetikën historike të gjuhës shqipe*. Tiranë.
- Çeliku, M. (1997), *Mbi disa çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe*. Në: “Probleme të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe”. Shtëpia botuese “Libri Universitar”, Tiranë, f. 9-19.
- Çeliku, M., Karapinjalli, M., Stringa, R. (1998), *Gramatika praktike e gjuhës shqipe*. Toena, Tiranë.
- Demiraj, Sh. (1969), *Rreth klasifikimit të foljeve në zgjedhime*. SF, 3/1969, f. 193-201.
- Demiraj, Sh. (1986), *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. Tiranë.
- Dozon, A. (1878), *Manuel de la Langue Chkipeou Albanaise. Grammaire – Chrestomathie –Vocabulaire*. Paris.
- Dhrimo, A., Angoni, E., Hysa, E., Lafe, E., Likaj, E., Agalliu, F. & Demiraj, Sh. (1976), *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe*. Tiranë.
- Hahn, J. G. (1854), *Albanesische Studien – Heft II*. Jena, Verlag von Friedrich Mauke. Druck der kaiserlich-königlichen Hof und Staatsdruckerei in Wien.
- Kristoforidhi, K. (1882), Γραμματική της αλβανικής γλώσσας κατά την τώσκιην διαλέκτον. Εν Κωνσταντινούπολει. (Përkthimi në shqip: *Gramatika e gjuhës shqipe sipas dialektit toskë*, në: “Konstandin Kristoforidhi, Vepra 1”, botim i Universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, “SILVER”, 2001).

¹² Në këtë numër përfshihen vetëm foljet e parme dhe jo derivatet e tyre. Përfshirja e derivateve të tyre do ta çonte numrin mbi 100 folje të parregullta.

- Memushaj, R. (2012), *Morfonologji e eptimit të shqipes standarde* (botimi i dytë). INFOBOTUES, Tiranë.
- Memushaj, R. (1996, 2017), *Rreth lëvizjeve në sistemin foljor të gjuhës shqipe*. Në: “Studime albanologjike” 1996/2, f. 143-155; Memushaj, R., *Studime gjuhësore*, Tiranë, 2017, f. 47-59.
- Memushaj, R. (1987, 2017), *Rreth foljeve me temë të zgjeruar më -as*. Në: “Studime filologjike”, 1987/2, f. 27-35; Memushaj, R., *Studime gjuhësore*, Tiranë, 2017, f. 35-46.
- Memushaj, R. (2003, 2017), *Për një ndarje tjetër në klasa të foljeve të shqipes*. Në: “Studime filologjike”, 2003/1-2, f. 41-62; Memushaj, R., *Studime gjuhësore*, Tiranë, 2017, f. 61-84.
- Meyer, G. (1888), *Kurzgefaste albanesische Grammatik*. Leipzig.
- Pekmezi, Gj. (1908), *Grammatik der albanesischen Sprache (Laut- und Formenlehre)*. Verlag des Albanesischen Vereins “Dija”, Wien.
- Resuli, N. (1985), *Grammatica Ablbanese*. Patron Editore, Bologna.
- Riza, S. (1966, 1994¹, 1997²). *Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore*. Në: “Selman Riza, Vepra 2”, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë.
- Rrota, J. (2006), *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*. Shkodër.
- Sheperi, I. D. (1927), *Gramatika dhe Sindaksa e gjuhës shqipe (sidomos e Toskënishtes)*. Vlorë. Ribotuar në Romë, 1972.
- Teichmann, E. (2019), *Albanisch – Fremdsprachengrammatik*. ATHENA.
- Topalli, K. (2011), *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. Tiranë.

SUMMARY

DEFINING IRREGULAR VERBS IN ALBANIAN LANGUAGE

One of the most discussed, but at the same time the most debated issues, for which has not been reached a satisfied solution, remains the classification of the verbs of Albanian language; as well their main division in regular and irregular verbs. In this article we have focused in defining the set of irregular verbs, for which in Albanian recent grammars has been prevalent the tendency to present the verbal system as less affected by irregularities. In order to reach an objective solution to this issue, our first aim was to set out the most objective criteria for the division into regular and irregular verbs. For this we have started from defying the notion of ‘regularity’ and ‘irregularity’ in the verbal system of Albanian language. As ‘regularity’ we have defined the morphological rules that apply to all members of a verbal group, such as:

-The presence of two inflection themes in indicative, thanks to alternations **o –ua, e – ye** in aorist plural: *lexoj – lexuam, dëgjoj – dëgjuam, shkoj – shkuam; rrëfej – rrëfyem, ushqej – ushqyem* etc.;

-The presence of two inflection themes in indicative, thanks to alternations **ua - o, ye – e** in aorist singular: *shkruaj – shkrova, thyej – theva* etc.;

-The presence of two inflection themes in indicative, thanks to alternation **je - o** in aorist: *sjell – solla, vjel – vola* etc.;

-The absence of verbal endings in present indicative singular for the verbs with theme in consonants: *hap, kap, lidh, godit, ujit* etc.;

-Keeping the theme unchanged: *la-j, qa-j, ujit, godit, qëndis, kap etj.*

As ‘irregularity’ we have defined:

-The absence of verbal endings in present indicative singular for the verbs with theme in vocals: *ha, pi, rri, zë* etc.;

-The presence of verbal endings in present indicative singular for the verbs with theme in consonants: *ik-i, ik-ën, ik-ën; ec-i, ec-ën, ec-ën, hip-i, hip-ën, hip-ën;*

-The change of theme in 2 and 3 person singular present indicative *rrëshqas, rrëshqet; bërtas, bërtet; buças, buçet* etc.;

-Reoccurrence of thematic **-r/-n** in aorist singular: *bë-j – bë-r-a, zë – zur-a – zën-ë* etc.

Irregularities are in most cases the product of historical laws. We have defined all the verbs in which an irregularity is present as irregular verbs. So, according to our classification, the number of irregular verbs in Albanian language arrives at 85 (only non-derived verbs).

